



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. Prot.

Vlorë, më11.2016

Vendim
Nr. 65, datë 14.11.2016

PËR ADMINISTRIMIN E DOKUMENTACIONIT AKADEMIK DHE
ADMINISTRATIV TË FAKULTETEVE DHE DEPARTAMENTEVE

Në mbështetje të pikës **d** dhe **k** të nenit **38** në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 14.11.2016

VENDOSI:

1. Çdo fakultet ruan dhe administron këto dokumente të detyrueshme:
 - a) **Dekani/dekanati ruan dhe administron:**
 1. Kurrikulën e çdo programi studimi që ofron njësia kryesore (planet mësimore, rregulloren e studimeve, programet e lëndëve, syllabuset etj.).
 2. Strukturën e vitit akademik.
 3. Formular përmbledhës të ngarkesave mësimore e kohës vjetore të punës së pedagogëve.
 4. Listat emërore të pedagogëve me kohë të pjesshme dhe të ftuar të propozuara dhe të miratuara nga rektori.
 5. Urdhrrat, udhëzimet dhe vendimet e MAS-it, Senatit të UV-së, Rektorit, Rektoratit dhe Dekanit/dekanatit të fakultetit si dhe gjithë korrespondencën tjetër shkresore hyrëse apo dalëse.
 6. Statutin, Rregulloren e studimeve, Rregulloren e Etikës së UV-së, Rregulloren e Fakultetit si dhe Kodin e Punës në RSH.
 7. Planet vjetore të punës pedagogjike, kërkimore e shkencore të njësisë kryesore dhe ato të departamenteve.
 8. Vendimet dhe veprimtaritë e dekanateve.
 9. Procesverbalet e mbledhjeve që organizon Dekani apo dekanati.
 10. Guidën e fakultetit.
 11. Raporte dhe analiza pune.
 12. Një kopje të marrëveshjeve të lidhura nga UV.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

b) Departamenti ruan dhe administron:

1. Urdhrrat, udhëzimet dhe vendimet e MAS-it, Senatit të UV-së, Rektorit, Rektoratit dhe dekanit/dekanatit të fakultetit si dhe gjithë korrespondencën tjetër shkresore hyrëse apo dalëse.
2. Kriteret e hartuara nga departamenti dhe ato të miratuara nga Rektori për përzgjedhjen e personelit akademik me kohë të pacaktuar, të caktuar (me kohë të plotë, të pjesshme) dhe personaliteteve të ftuara, procesverbalet e procedurave të përzgjedhjes së tyre, skemat tekniko-praktike të përzgjedhjes si dhe vendimmarrjen përfundimtare.
3. Dokumentacioni origjinal i çdo procesi zgjedhor i kryer nga vetë departamenti apo i organizuar nga KZI brenda tij.
4. Regjistrat e pedagogëve ku pasqyrohen komponentët e vlerësimit të vazhduar gjatë procesit mësimor.
5. Marrëveshjet standarde të organizimit të kohës vjetore të punës përfshirë dhe ngarkesat mësimore vjetore të pedagogëve në auditor.
6. Planet vjetore të punës pedagogjike, kërkimore, shkencore dhe kulturore, sportive e artistike në funksion të studentëve.
7. Kurrikulat e programeve të studimeve që zhvillon departamenti: Rregulloren e programit të studimit, planet mësimore, programet mësimore të lëndëve, syllabuset, suplementet etj.
8. (Një kopje e tyre dërgohet vetëm në Dekanat dhe Zyrën e Standardeve dhe të Kurrikulave).
9. Vendimet për mënyrën e zhvillimit të provimeve dhe komisionet e tyre.
10. Vendimet për caktimin e temave të diplomave, udhëheqjeve të tyre dhe deklaratat përkatëse (bashkëlidhur këtij materiali).
11. Kriteret për përcaktimin e studentëve që do të marrin temë diplome.
12. Vendimet për ekuivalentimin e lëndëve për studentë të ardhur nga universitetet e tjera dhe apo programe të dyta studimi.
13. Vendimet për studentët që nuk kanë frekuentuar në masën e caktuar konform rregullores së studimit.
14. Punimet e diplomave të studentëve, oponencat, deklaratat e studentit dhe udhëheqësit.
15. Listën e teksteve mësimore të detyrueshme, rekomanduar studentëve dhe argumentet shkencore e pedagogjike përzgjedhëse (ose jo) për secilin titull të paraqitur.
16. Strukturën e vitit akademik.
17. Raportet dhe analizat e punës mësimore, kërkimore, shkencore e botuese pune.
18. Procesverbalet e çdo mbledhjeje për të gjitha tipologjitë e tematikave.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

Shënim:

Nëse dekani kërkon nga njësitë bazë kopje të një dokumentacioni që ai e gjykon se duhet ta ketë në administrim, përgjegjësi i njësisë bazë është i detyruar t’ia dorëzojë atë.

Bashkëlidhur ndodhen 6 (gjashtë) shtojca për dokumentacionin e punimeve të diplomave.

2. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Shtojca 1

PROJEKTPROPOZIM PËR TEZËN

1. Të dhëna të përgjithshme

Emri i studentit: _____

Programi i studimit: _____

Udhëheqësi i propozuar: _____

2. Përshkrimi i projekpropozimit

- Titulli i temës
- Abstrakti
- Fjalët kyçe
- Hyrja
- Sfondi teorik
- Formulimi i problemit dhe qëllimet e hulumtimit
- Pyetjet dhe hipotezat e hulumtimit
- Metodatat dhe teknikat e hulumtimit
- Rezultatet e hulumtimit
- Literatura

Shënim zyrtar:

Vendimi i marrë nga komisioni përgjegjës (emri i komisionit) më(datë):

Studenti..... lejohet të kryejë punimin shkencor me temë

.....
Udhëheqësi shkencor do të jetë:

.....

(Firma e personit përgjegjës)



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Shtojca 2

FORMATI I BALLINËS ME ELEMENTET PASUES

UV

FAKULTETI _____

DEPARTAMENTI _____

PROGRAMI I STUDIMIT _____

TITULLI I TEMËS

Paraqitur në kërkim të diplomës Master Profesional/Master i Shkencave në

Punuar nga studenti _____

Udhëhequr nga Prof. Dr./Prof. asoc/Dr _____



**REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK**

Shtojca 3

DEKLARATË AKADEMIKE

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij.

Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

- **TITULLI (shqip, anglisht)**
- **ABSTRAKT (shqip, anglisht)**
- **FUSHA E STUDIMIT (shqip, anglisht)**
- **FJALËT KYÇE (shqip dhe anglisht)**
- **ADRESA:**

**EMRI, MBIEMRI I STUDENTIT
NËNSHKRIMI**



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Shtojca 4

UV
FAKULTETI _____
DEPARTAMENTI _____
PROGRAMI I STUDIMIT _____
VLORË, më _____

LEJE PËR MBROJTJEN E PUNIMIT TË DIPLOMËS

Bazuar në përmbushjen e kritereve të përcaktuara në Manualin e Punimit të Diplomës jap lejen për mbrojtjen para Komisionit të Vlerësimit të punimit me temë:

.....
.....

përgatitur nga, student/e e Programit

UDHËHEQËSI SHKENCOR

.....

Vlorë,

më.....



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

Shtojca 5

UV
FAKULTETI _____
DEPARTAMENTI _____
PROGRAMI I STUDIMIT _____
VLERËSIM I SHKURTËR I UDHËHEQËSIT SHKENCOR
PËR PUNIMIN E DIPLOMËS MP/MSH NË _____ ME
TEMË:

PËRGATITUR NGA _____

.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....

Udhëheqësi shkencor: _____

VLORE, më _____



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

Shtojca 6

UV
FAKULTETI _____
DEPARTAMENTI _____
PROGRAMI I STUDIMIT _____
FLETË VLERËSIMI
PËR PUNIMIN E DIPLOMËS
“MASTER PROFESIONAL/SHKENCOR NË _____”
Emri i studentit: _____
Titulli i temës së punimit: _____

Nr.	Kriteret e vlerësimit	Pikët e parashikuara	Pikët e fituara
1	Demonstrimi i një vetëdijeje profesionale në trajtimin e çështjes së zgjedhur (përcaktimi i qartë i çështjes kërkimore, përputhja e trajtesës me temën, përshkrimi dhe analiza e thellë e rezultateve, paraqitja e përfundimeve dhe rekomandimeve)	25	
2	Përdorimi i metodologjisë shkencore dhe i instrumenteve të kërkimit (përcaktimi i detyrës shkencore në përputhje me temën, përcaktimi i hipotezave ose i pyetjeve kërkimore, përcaktim i subjekteve, i kampionit, përzgjedhja e metodave dhe e instrumenteve të përshtatshëm)	15	
3	Origjinaliteti i punimit (formulimi origjinal i temës, këndvështrimi origjinal i temës, struktura origjinale, rezultate dhe analiza origjinale)	20	
4	Dobia e punimit (dobia e punimit për zhvillimin e teorisë, për zbatimin në praktikë, për studime të mëtejshme)	15	



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

5	Cilësia e të shkruarit (respektimi i stilit shkencor të të shkruarit dhe i rregullave të drejtshkrimit)	10	
6	Paraqitja teknike (respektimi i kërkesave teknike të formatit të punimit)	05	
7	Cilësia e prezantimit	10	
	Shuma e pikëve		

Komisioni i vlerësimit:

- 1.
- 2.
- 3.
- 4.
- 5.

VLORË, më _____